



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr.1020/5Prot.

Tiranë, më 23/12/2016

V E N D I M

Nr. 154, Datë 23.12.2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË NDËRMARRJEN QENDRA BALNEARE DIBËR "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Ndërmarrjen Qendra Balneare Dibër, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2016.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga Ndërmarrja Qendra Balneare Dibër, nuk njihen kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si pasojë konstatuam se entiteti nuk ka ngritur grupin e menaxhimit strategjik (GMS). Mos funksionimi i këtij grupi është pasuar me mungesë të një strategjie për evidentimin dhe vlerësimin e risqeve të brendshme në arritjen e objektivave të saj, gjithashtu sjell si pasojë mos programimin e

masave që do të minimizonin risqet që rrezikojnë objektivat strategjik të saj. Nuk është hartuar dhe miratuar rregjistrin e riskut dhe gjurma e auditimit. Konstatuam mungesën e rregullave të qarta për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme. Kjo situatë dhe praktikë menaxheriale është në kundërshtim me kërkesat e neneve 8, 16, 22, 23 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 54 datë 15.7.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

1.1. Rekomandimi: Ndërmarrja Qendra Balneare Dibër, të hartojë regjistrin e riskut dhe nga Titullari të ngrihet grupi për menaxhimin strategjik, të hartohet gjurma e auditimit dhe të punohet për të forcuar sistemet e kontrollit të brendshëm.

Në hartimin e raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të analizohen të gjithë elementët e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke përcaktuar dobësitë e sistemit dhe masat për përmirësimin e tij.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ndërmarrja Qendra Balneare Dibër, nuk ka regjistër të aktiveve të qëndrueshme të njësisë, me të dhënat e nevojshme, që përfshijnë, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale si shtesë në rritjen e vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kjo praktikë jo vetëm ekspozon aktivitetin ndaj riskut të keqadministrimit, por bie në kundërshtim edhe me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III-të, pika 30.

2.1.Rekomandimi: Zyra e Financës së Ndërmarrjes të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme dhe të plotësohet me të dhënat e nevojshme, për çdo aktiv në veçanti, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Ndërmarrja Qendra Balneare Dibër, për vitet 2013-2016, ka kryer aktivitetin pa pasur program ekonomik dhe financiar vjetor dhe afat mesëm, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Ndërmarrjes.

Nga Drejtoria e Ndërmarrjes dhe Këshilli Drejtues i saj, nuk janë bërë analiza të kostove për shërbimin e larjeve sipas pavionëve dhe nuk janë evidentuar dhe analizuar të ardhurat sipas llojit të shërbimit të larjes. Nuk ka analiza ekonomike dhe financiare për shërbimin e larjes për klientët e akomoduar në hoteleritë private, për shërbimin e larjeve ambulante, për shërbimin e terapisë të baltës etj. Mungesa e programeve vjetore të miratuara, sjell jo vetëm mungesën e vizionit por shoqërohet me mungesë të programimit të nivelit të kostove të përshtatshme për të përballuar flukset e pritshme të klientëve. Mungesa e programimit të kostove sjell praktika prokurimi në kushte emergjence dhe negocimi me pasojë uljen e efektivitetit të shpenzimeve dhe ineficencë në përdorimin e burimeve dhe mosveprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar nenet 6, 7, 10 dhe 23.

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Ndërmarrjes Balneare, të përgatisë programe të zhvillimit ekonomik e financiar vjetore e afatmesëm dhe ti miratojë ato në Këshillin Drejtues të saj në fillim të çdo viti. Të marrë masat për evidentimin e shpenzimeve dhe të ardhurave sipas llojit dhe natyrës ekonomike të shërbimit. Të analizojë rezultatet ekonomike dhe financiare

sipas qendrave të aktivitetit duke krijuar mundësinë për të vlerësuar drejt jo vetëm koston sipas aktiviteteve të ndryshme por edhe një vlerësim të kujdesshëm të çmimit për çdo shërbim të ofruar.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në Qendrën Balneare, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale. Nga auditimi u konstatua se evidencat kontabël të transaksioneve ekonomike, kishin mangësi kështu:

a- Mandat arkëtimet (për hyrjet në arkë të vlerave monetare), kanë bashkëngjitur kuponët e kasës elektronike, por nuk janë firmosur nga faturistët e shërbimit të larjes, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar pika 68/a.

b-Nuk është mbajtur ditari i shitjeve për rastet e faturimeve të shërbimit të larjes për klientët e akomoduar në hotelet e subjekteve private, por ato janë hedhur në librat mujore të shitjeve të deklaruara në Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar nenet 3, 6.

c-Janë nxjerrë bilancet financiare në fund të periudhave ushtrimore vjetore, por në asnjë rast, ato nuk janë miratuar nga një ekspert kontabël, në kundërshti me kërkesat e ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, neni 9, pikat 1, 2.

d-Nga auditimi mbi saktësinë e disa llogarive inventariale të aktivitetit të bilancit financiar të fund vitit 2015 me të dhënat e evidencave kontabël, u konstatua se gjendja e llogarisë “Banka” është më tepër në vlerën 23,046 lekë krahasuar me ekstraktin e bankës dhe vlera inventarëve për makineri pajisje, mjete transporti, pajisje kompjuterike dhe inventar i imët është më tepër në vlerën 3,130,027 lekë se sa vlera e pasqyruar në pasqyrat financiare.

4.1. Rekomandimi: Nga titullari i ndërmarrjes dhe nga Këshilli Drejtues, të merret në analizë raportimi financiar jo i saktë duke reflektuar masa konkrete për organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

Nga zyra e financës, të sistemohen llogaritë financiare duke proceduar sipas kërkesave ligjore, me qëllim që kontabiliteti të pasqyrojë gjendjen reale sipas rezultateve të inventarizimit fizik dhe gjendjen monetare sipas ekstraktit të bankave.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Derdhja në bankë e arkëtimeve për shërbimin e larjes, nuk është bërë rregullisht në fund të çdo dite. U konstatuan disa raste të derdhjes të shumave të arkëtuara, në periudha 3-4 ditore në vlera të mëdha monetare. Drejtoria e Ndërmarrjes Balneare dhe Këshilli Drejtues i saj, nuk kanë miratuar limitin e gjendjes së arkës, në zbatim të kërkesave të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

5.1.Rekomandimi: Ndërmarrja e Qendrës Balneare, të miratojë limitin e gjendjes së arkës dhe të implementojë sisteme kontrolli për dokumentimin dhe evidentimin e drejtë të arkëtimeve. Kjo praktikë do të garantonte sigurinë e vlerave të arkëtuara nëpërmjet arkës, në zbatim të kërkesave ligjore.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan problematika të lidhura me mënyrën e dokumentimit dhe evidentimit të lëvizjeve të mallrave/materialeve në magazinë. U

konstatua se fletë hyrjet e magazinës, nuk kanë të bashkangjitur dokumentin justifikues si procesverbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit (kjo e verifikuar në 196 transaksione), ndërkohë që fletë daljet e magazinës për mallra/ materiale, nuk kanë të bashkangjitur dokumentacionin urdhërues përkatës i cili urdhëron për daljen e mallrave/materialeve nga magazina (mungon fletë kërkesa, plani i shpërndarjes për 314 transaksione, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 01.01-30.09.2016). Kjo praktikë e verifikuar bie në kundërshtim me përcaktimet dhe kërkesat e UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Pikat 37, 38, 54.

6.1.Rekomandimi: Ndërmarrja Qendra Balneare, të marrë masa në vijimësi për dokumentimin e aktiveve me fletë hyrje të magazinës të shoqëruar me dokumente justifikues bashkangjitur në çdo rast për blerje mallrash e materiale dhe me fletë dalje të magazinës të shoqëruar me dokumente urdhërues për çdo rast të daljeve të mallrave e materialeve nga magazina në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Pikat 37, 38, 54.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Për vitet 2013-2016, nga Qendra Balneare Dibër, nuk është përpiluar regjistri i parashikimit të prokurimeve dhe as regjistri i realizimit të prokurimeve. Për këtë periudhë, janë zhvilluar gjithsej 3 procedura prokurimi me tender, kështu është zhvilluar tenderi me objekt: “Blerje mish vici” me fondin limit 770,000 lekë dhe “Blerje artikuj ushqimorë” me fondin limit 650,000 lekë, në vitin 2013 ndërsa në vitin 2014 tenderi me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë” me fondin limit 632,000 lekë pa tvsh. Në procedurat e prokurimit të realizuara dhe të audituara, u konstatuan shkeljet ligjore:

Mungon procesverbal i komisionit të njësisë së prokurimit për miratimin e dokumenteve të tenderit, të llojit të prokurimit që do të zgjidhet si dhe për miratimin e subjekteve që do të ftohet të marrin pjesë në konkurrim, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 12.

Me subjektet fituese të tenderit, nuk janë lidhur kontrata në përfundim të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9632, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin Civil” i ndryshuar neni 850. Dosjet e tenderit, nuk janë inventarizuar dhe arkivuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim.

7.1.Rekomandimi: Qendra Balneare Dibër, të riorganizojë punën për të programuar dhe realizuar sigurimin e mallrave dhe të shërbimeve përmes procedurave të prokurimit Publik. Të organizohet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Njësia e Prokurimit si dhe të trajnohen specialistët që do të përfshihen në këto struktura.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Qendra Balneare Dibër, si çdo subjekt tjetër me aktivitet ekonomik, ka detyrimin për të paguar Taksat Vendore. Në paketat fiskale të miratuara nga Këshilli i Bashkisë Peshkopi (Sot Bashkia Dibër) për vitet 2013-2016, është përcaktuar taksa e përkohshme 50 lekë/ditë për çdo klient të regjistruar në hotelin e saj, në hotelet private të cilat shërbimin e larjes e kryejnë në Qendrën Balneare si dhe ndaj çdo klienti tjetër. Kjo tarifë, sipas miratimit në paketën fiskale, i mbahet klientit për shërbimin e ofruar. U konstatua se kjo tarifë, në asnjë rast, nuk i është faturuar klientëve. Detyrimi ndaj bashkisë për taksën e përkohshme, është përballuar nga të ardhurat e veta ku për vitin 2015 janë paguar 2,100 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme, janë shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar si dhe vendimet e Këshillit Drejtues mbi miratimin e tarifave të shërbimit të larjes.

8.1 Rekomandimi: Qendra Balneare, të marrë masat për të aplikuar taksën e larjes ndaj çdo klienti në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar dhe të paketës fiskale të miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë Dibër.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi mospërputhjet me legjislacionin në fuqi, udhëzimet dhe VKM-të, i rekomandojmë Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër, marrjen në shqyrtim, evidentimin dhe kontabilizimin e tyre, në lidhje me detyrimet e konstatuara si dëm ekonomik, të cilat në total janë në shumën **1,194,184 lekë**, për:

1.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se nuk janë plotësuar fletët e udhëtimit për të justifikuar dhe dokumentuar harxhimin e karburantit për lëvizjet me automjet nga ish titullari i Ndërmarrjes përkatësisht:

-gjatë vitit 2013, në 8 raste për 2600 litra Gazoil në vlerë 473,200 lekë dëm ekonomik.

-gjatë vitit 2014, në 7 raste për 2400 litra Gazoil në vlerë 417,600 lekë dëm ekonomik.

-gjatë vitit 2015, në 7 raste për 1566 litra Gazoil në vlerë 256,884 lekë dëm ekonomik, në total 6,566 litra **për vlerën 1,147,684 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Ndërmarrjes, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35/b dhe 36.

1.1.Rekomandimi: Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **1,147,684 lekë** nga ish Drejtori I.Q. për periudhën 1.01.2013 -31.08.2015.

Deri më 30.06.2017

2.Gjetje nga auditimi: Drejtori i Ndërmarrjes ka përfituar padrejtësisht **vlerën 30,000 lekë** për kompensimin të shërbimit të transportit, në muajin dhjetor 2013 dhe janar 2014 e cila përbën dëm ekonomik, në shkelje të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” i ndryshuar neni 2, pika 2.

2.1.Rekomandimi: Të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **30,000 lekë** nga ish Drejtori I.Q. për përfitim të padrejtë të kompensimit për shërbimin e transportit.

Deri më 30.06.2017

3.Gjetje nga auditimi Nga zyra e financës nuk është kryer ndalesa për tatimin mbi të ardhurat nga shpërblimet në vlerën **16,500 lekë në 30 raste**, dëm ekonomik për shpërblimet e akorduara gjatë vitit 2015, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, neni 8 dhe UMF nr. 31 datë 29.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat të ndryshuar”.

3.1.Rekomandimi: Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **16,500 lekë** nga 30 punonjës, për përfitim të padrejtë.

Deri më 30.06.2017

C.MASA DISIPLINORE:

C/1 .Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 9 pika 2; 11 dhe 12, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, mbasi të analizojë gjetjet dhe rekomandimet, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 2 punonjës:

Nga “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës” deri “Në largim nga detyra” për:

1. S.K. me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër për periudhën 01.09.2015 deri 30.09.2016:

-Për mos zbatimin e kërkesave në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili nuk ka ngritur grupin e menaxhimit strategjik (GMS), nuk ka strategji për evidentimin dhe minimizimin e risqeve që rrezikojnë objektivat e Ndërmarrjes; Nuk është krijuar regjistri i riskut dhe gjurma e auditimit;Nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme. Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 8, 16, 22, 23 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 54 datë 15.7.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Për mos hartimin e programit ekonomik dhe financiar vjetor dhe afat mesëm, të Ndërmarrjes, nuk ka bërë analiza të kostove për shërbimin e larjeve sipas pavionëve dhe nuk janë evidentuar dhe analizuar të ardhurat sipas llojit të shërbimit të larjes. Nuk ka analiza ekonomike dhe financiare për shërbimin e larjes për klientët e akomoduar në hotelitë private, për shërbimin e larjeve ambulante, për shërbimin e terapisë të baltës etj., mosveprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar nenet 6, 7, 10 dhe 23.

-Për mos programimin e blerjeve të mallrave ushqimore në fillim të vitit, nuk janë lidhur kontrata me subjektet fitues në përfundim të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin Civil” i ndryshuar neni 850.

-Për mos hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve dhe as regjistri i realizimit të prokurimeve. Mungon procesverbali i komisionit të njësisë së prokurimit për miratimin e dokumenteve të tenderit, të llojit të prokurimit që do të zgjidhet si dhe për miratimin e

subjekteve që do të ftohet të marrin pjesë në konkurrim, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 12. Me subjektet fituese të tenderit, nuk janë lidhur kontrata në përfundim të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin Civil” i ndryshuar neni 850. Dosjet e tenderit, nuk janë inventarizuar dhe arkivuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim.

2. E.M. me detyrë Financier, për periudhën 29.09.2015 deri 30.09.2016.

-Për mos mbajtjen e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme të njësisë, me të dhënat e nevojshme, që përfshijnë, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III-të, pika 30.

-Për mos plotësimin e mandat arkëtimeve për hyrjet në arkë të vlerave monetare, të cilat duhej firmosur nga faturistët e shërbimit të larjes që presin kuponët e kasës elektronike, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar pika 68/a.

-Për mos mbajtje të ditarit të shitjeve për rastet e faturimeve të shërbimit të larjes për klientët e akomoduar në hotelet e subjekteve private, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar nenet 3, 6.

-Për mosplotësim të fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës me dokumente justifikues si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit për rastet e hyrjeve dhe mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletë kërkesës, planit të shpërndarjes, për rastet e daljeve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Pikat 37,38,54.

-Për mos kryerjen e ndalesave për tatimin mbi të ardhurat nga shpërblimet në vlerën 16,500 lekë në 30 raste,dëm ekonomik për shpërblimet e akorduara gjatë vitit 2015, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

C.2. Shkarkimi i Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër

Bazuar në ligjin nr. 139/2015,datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54, neni 64 si dhe ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar Neni 19, pika 2, mbështetur në faktet e vërtetuara gjatë auditimit, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dibër sa vijon:

1.Të shkarkojë Këshillin Drejtues të Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër, i përbërë:

-S.K. me detyrë administrator i ndërmarrjes,

-E.M. me detyrë Financier,

-M.P. me detyrë mjek,

-N.Sh. me detyrë arkëtare,

-D.K. me detyrë k/infermiere,

pasi, Këshilli Drejtues, është emëruar nga ish-Kryetari i Bashkisë Dibër H.F. me Vendimin nr. 251, datë 08.07.2016, pa u miratuar më parë në Këshillin Bashkiak.

Ky vendim është nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar Neni 19, pika 2, i cili përcakton se: “Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe midis tyre, drejtori emërohet për një periudhë katërvjeçare nga ministri, drejtuesi i institucionit tjetër qendror ose nga organi i pushtetit lokal të cilët kanë edhe të drejtën e shkarkimit me një vendim të motivuar, ata mund të riemërohen”.

2. Të emërojë Këshillin e Ri Drejtues dhe Drejtorin e Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër, mbas marrjes së miratimit në Këshillin e Bashkisë, bazuar në ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar Neni 19, pika 2. i cili përcakton se Këshillin Drejtues dhe Drejtorin e emëron për një periudhë katërvjeçare organi i pushtetit lokal.

D-TË TJERA

D.1. Për vlerësim Organit të Prokurorisë Dibër

Nisur nga disa mangësi dhe shkelje ligjore të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit në Qendrën Balneare Dibër, ky Raport do të përcillet Organit të Prokurorisë për dijeni dhe vlerësim.

Shënim:

Për punonjësit e larguar dhe nuk kanë adresë:

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore,

“Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”, për:

- H.F. me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Peshkopi, për periudhën 19.05.2016 deri më datën 03.10.2016.

- I.Q. me detyrë ish Drejtor i Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër, për periudhën 01.01.2013 deri më datën 31.08.2015.

- I.V. me detyrë ish Financier i Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër, për periudhën 01.01.2013 deri më datën 28.09.2015.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R